



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



IST Channel
Valon Maloku
Drejtor
Prishtinë



VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2024/13 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për IST Channel
(Pala Përgjegjëse)

Faktet

1. KPM ka miratuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë KKPM-2016/3, i cili ka hyrë në fuqi më datë 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datë 21 dhjetor 2023 ka miratuar Rregulloren KPM-2023/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale. Kjo Rregullore ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e programeve të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre fizik, mendor dhe moral, mbrojtjen e fëmijëve gjatë përfshirjes së tyre në përmbajtje mediale, me fokus të veçantë mbrojtjen e fëmijëve të cenueshëm, si dhe mënyrën e kategorizimit, sinjalizimit dhe kohën e transmetimit të programeve që ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mendor, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve.
3. KPM ka bërë monitorimin ex-officio të Palës përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 lidhur me transmetimin e programit “It’s my home” të formatit Reality Show të datës 14 shtator 2022.
4. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 15 shtator 2022 ka gjetur se Pala përgjegjëse, gjatë transmetimit të këtij Reality Show, ka transmetuar një diskutim/mosmarrëveshje në mes të disa banorëve, në të cilën ka pasur nxitje të dhunës dhe është shkaktuar lëndim fizik, veprim ky i cili është në kundërshtim me nenin 3, paragrafi 1. Gjithashtu, gjatë transmetimit të këtij Reality Show është përdorur gjuhë vulgare dhe ofenduese, përmbajtje kjo programore e transmetuar para kohës së lejuar me nenin 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
5. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 15 shtator 2022, me datë 26 shtator 2022, i ka dërguar Njoftim Palës përgjegjëse lidhur për shkelje të nenit 3, paragrafi 1, nenit 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03 përmes të cilit e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe ka kërkuar nga Pala përgjegjëse të veprojë në pajtim me Kodin të Etikës KKPM-2016/03, si dhe e ka udhëzuar të ndërmarrë masat e duhura që përmbajtjet e tilla të mos transmetohen në të

- ardhmen, duke i ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh të përgjigjen dhe të ofrojnë sqarimet e tyre në raport me shkeljet e lartpërmendura.
6. KPM nuk ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje.
 7. KPM në mënyrë të vazhdueshme ka bërë monitorimin ex-officio të Palës Përgjegjëse, për të vlerësuar pajtueshmërinë me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 në lidhje me transmetimin e pjesëve të emisionit “Reality Show It’s My Home”. Monitorimi është bërë për tri (3) ditë, për datat 1, 2 dhe 4 dhjetor 2023.
 8. KPM, në bazë të Raportit të monitorimit të datës 7 dhjetor 2023, ka gjetur se Pala përgjegjëse me datat 1 dhe 2 dhjetor 2023, gjatë transmetimit të pjesëve të emisionit “Reality Show It’s My Home” ka pasur përdorim të gjuhës vulgare dhe ofenduese nga ana e banorëve e cila nuk duhet të transmetohet para kohës së kufizimit të përcaktuar me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
 9. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 7 dhjetor 2023, me datë 14 dhjetor 2023, i ka dërguar Njoftim Palës përgjegjëse me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe përmes të cilit e ka udhëzuar që në të ardhmen të ndërmerrni veprimet e duhura që një gjuhë e tillë mos të transmetohet, duke i ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh të përgjigjen dhe të ofrojnë sqarimet e tyre në raport me shkeljet e lartpërmendura
 10. KPM nuk ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje
 11. KPM gjithashtu, ka bërë monitorimin ex-officio të Palës përgjegjëse për datat 19, 20 dhe 22 janar 2024 për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM 2023/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele, lidhur me transmetimin e Reality Show “Its My Home” të përmbajtjeve programore të cilat mund të jenë të dëmshme për fëmijë dhe të mitur.
 12. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 24 janar 2024, ka gjetur se Pala përgjegjëse me datat 19, 20 dhe 22 janar 2024 ka transmetuar programin “It my home” para kohës së paraparë me rregullore (nga ora 24:00-06:00) dhe nuk ka ndërmarr veprimet teknike të kodimit me pin/kod, ashtu siç është e përcaktuar me Rregullores KPM--2023/01.
 13. KPM pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datë 25 janar 2024 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për shkelje, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar që të veproj në pajtim me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM 2023/01, duke i ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh të përgjigjen dhe të ofrojnë sqarimet e tyre në raport me shkeljet e lartpërmendura.
 14. KPM ka pranuar përgjigje me datë 6 shkurt 2024 nga Pala përgjegjëse, përmes së cilës thekson se kemi dëgjuar vetëm nga mediat, portalet që KPM ka inicuar rregulloret e reja për kodimin e emisioneve Reality. Na ka ardhur mirë që më në fund pas shumë kërkesave nga ana e jonë diçka e mirë është rregulluar me ligj. Se kur ka hy në fuqi dhe si, ne nuk kemi qenë të njoftuar. Mendoj që duhet përmirësuar komunikimi kur ka rregullore të reja që hyjnë në fuqi, edhe pse nuk e dinim se si do të funksionon kodimi, sepse nuk është në dorën tonë por të

operatoreve kabllore, ne kemi menduar që nuk do të jetë asgjë në dorën tonë. Pasi edhe ka disa ditë që nëpër rrjetet tona sociale kemi pasur kërkesa nga ana e shikuesve për shifrën e kodit, ne aty e kemi kuptuar që operatorët e shpërndarjes veç e kanë rregulluar atë punë, dmth kanali jonë është me kod. Letra juaj na zuri në befasi dhe menjëherë kemi marr masa që mos të transmetojmë më asgjë në Tv pa u sqaruar me ju, andaj ju kishim lutë që të na njoftoni se si bëhet dhe kush e ka në dorë kodimin.

15. KPM ka gjetur se pala përgjegjëse edhe përkundër Njoftimeve për Shkelje të KPM-së të datës 26 shtator 2022, të datës 14 dhjetor 2023, dhe datës 25 janar 2024 ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri edhe me Rregulloren KPM-2023/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale.

Analiza ligjore

16. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 dhe Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM 2023/01.

17. Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 3, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë ndonjë material që promovon ose nxitë krimin dhe aktivitetet kriminale ose që përmban rrezikun e shkaktimit të dëmit që mund të rezultojë me vdekje, lëndim, dëmtim të pronës apo ndonjë formë tjetër të dhunës.”

18. Pala përgjegjëse gjithashtu ka vepruar në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“OSHM-të nuk duhet të transmetojnë para kohës së kufizimit (nga ora 24:00 në 05:00) asnjë material që përmban gjuhë vulgare dhe ofenduese.”

19. KPM bazuar në Raportit e monitorimit të datës 15 shtator 2022 ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë transmetimit të “Reality Show It’s My Home” ka transmetuar një debat/ mosmarrëveshje në mes të disa banorëve, në të cilën ka pasur nxitje të dhunës dhe është shkaktuar lëndim fizik, veprim ky i cili është në kundërshtim me nenin 3, paragrafi 1. Gjithashtu gjatë transmetimit të këtij Reality Show është përdorur gjuhë vulgare dhe ofenduese, përmbajtje kjo programore e transmetuar para kohës së lejuar me nenin 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

20. KPM bazuar në Raportit e monitorimit të datës 7 dhjetor 2023, ka gjetur se Pala përgjegjëse me datat 1 dhe 2 dhjetor 2023, gjatë transmetimit të pjesëve të emisionit “Reality Show It’s My Home” ka pasur përdorim të gjuhës vulgare dhe ofenduese nga ana e banorëve e cila nuk duhet të transmetohet para kohës së kufizimit, ashtu siç është përcaktuar me nenin 4, paragrafi 1, Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

21. KPM, bazuar në Raportin e monitorimit të datës 24 janar 2024 ka gjetur se Pala përgjegjëse ka transmetuar programe Reality Show para kohës së paraparë me rregullore (nga ora 24:00-

06:00) dhe nuk ka ndërmarr veprimet teknike të kodimit me pin/kod, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 6, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM 2023/01 i cili përcakton se:

“Programet e formatit shfaqje reale televizive (reality show ose reality TV), njoftimet e transmetimit të tyre, si dhe programet që tregojnë pasqyra të ngjarjeve në ato përmbajtje, shënohen me 18+ dhe mund të transmetohen vetëm në periudhën nga ora 24:00 deri në 06:00. Ky kufizim nuk zbatohet për përmbajtjen e shfaqur me mbrojtje teknike (kodim me pin).”

22. Transmetimi i programeve Reality Show në bazë të nenit 7, paragrafi 6 të Rregullores KPM 2023/01, pa mbrojtje teknike, mund të behet vetëm nga ora 24 deri në ora 06:00 dhe se përjashtimisht transmetimi i këtij formati mund të behet edhe para orës 24:00 nëse zbatohen masat mbrojtëse teknike (pin/kodi). Pretendimi i Palës përgjegjëse se kodimi nuk mund të behet nga televizioni por nga operatorët e shpërndarjes nuk paraqet arsyetim të bazuar ligjor dhe nuk krijon hapësirë ligjore që këto formate të transmetohen para kohës se lejuar, sepse këto formate në parim nuk duhet të transmetohen para orës 24:00. Transmetimi para orës 24:00 paraqet përjashtim nga zbatimi i normës dhe është i kushtëzuar me kodimin e kanalit (mbetet nën përgjegjësin e televizionit sigurimi i mekanizmave për kodimin e kanalit, në të kundërtën përmbajtjet e tilla nuk mund të transmetohen para orës 24:00).
23. KPM si rrethane rënduese për Palën përgjegjëse ka konsideruar shkeljet e vazhdueshme edhe përkundër njoftimeve dhe kërkesave për të veprua në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 dhe Rregulloren KPM-2023/01.
24. KPM, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar Pala përgjegjëse ka bërë shkelje nenin 3, paragrafi 1 dhe nenit 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, si dhe ka transmetuar programe Reality Show para kohës së kufizimit në mënyrë të pa koduar duke vepruar kështu në kundërshtim dhe të nenit 7, paragrafi 6, të Rregullores KPM 2023/01.

Vendim

25. Pala Përgjegjëse, sanksionohet me **Gjobë** në shumë me gjobë në shumën prej pesëmijë (5 000) euro, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1 pika 1.3, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 3, paragrafi 1, nenit 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 dhe të nenit 7, paragrafi 6, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM 2023/01;
26. Pala përgjegjëse, obligohet që në të ardhmen të ketë kujdes në lidhje transmetimin e programeve të formatit Reality përmbajtje të cilat mund të transmetohen vetëm në periudhën 24:00 deri në 06:00 si dhe obligohet që të ndërmarr veprimet teknike të kodimit me pin/kod ashtu siç është e përcaktuar me nenin 7, paragrafi 6, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM 2023/01.
27. Pala Përgjegjëse obligohet që gjobën në shumë prej pesëmijë (5 000) euro e përcaktuar nga pika 25 e këtij vendimi, ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në xhirrollogarinë e KPM-së numër: 1000400070001635.

28. Në rast se Pala Përgjegjëse nuk e paguan gjobën brenda afatit të përcaktuar në pikën 27 të këtij vendimi, i njëjti kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme në procedurë përmbartimore.

E drejta për ankesë

29. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
30. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Jeton MEHMETI
Kryetar



15.04.2024

Datë